

VENDIM
Nr. 136, datë 2.3.2022

PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT
TË FËMIJËS ARBAS HOXHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, dhe të vendimit nr. 43, datë 19.1.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor, për vitin 2022”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të fëmijës Arbas Hoxha, në masën 2 000 000 (dy milionë) lekë.
 2. Ky fond përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
 3. Pagesa bëhet me paraqitjen e faturave përkatëse të institucionit të kurimit.
 4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama